

D E K R E T
Nr.1437, datë 1.4.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7853, DATË 13.7.1992 “PËR KOMPETENCAT PËR
CAKTIMIN E PAGAVE TË PUNËS”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në nenin 8 të ligjit nr. 7853, datë 13.7.1992 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e tretë fjalët “mbi 5 deri në 70 për qind” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “mbi 5 deri 100 për qind”.

Në paragrafin e katërt fjalët “mbi 70 për qind” të ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “mbi 100 për qind”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 1996.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha